

Intervistë me kryetarin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Ambasadorin Pavel Vacek

Dhënë gazetës “Tirana Times”
3 nëntor 2006

Z. Vacek, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka qenë prej vitesh një aktor i skenës politike shqiptare. A mund të na bëni një përmbledhje të çështjeve me të cilat është marrë Prezenca në vite dhe të na thoni nëse këto çështje kanë evoluar?

“Situata në Shqipëri ka evoluar me kalimin e viteve dhe po kështu edhe mandati dhe puna e Prezencës. Falë progresit të përgjithshëm të bërë që nga viti 1998, siguria në vend nuk është më çështje kryesore për ne. Nën mandatin e reduktuar të vitit 2003, ne jemi përqendruar në shumë në mirëqeverisjen dhe ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve, në ata sektorë ku jemi në gjendje të kontribuojmë. Gjithashtu, jemi përpjekur të kanalizojmë në shumë burime financiare dhe materiale përmes projekteve tona. Përsa i përket kësaj, kemi kaluar nga shumat prej disa dhjetra mijëra eurosh në fillim të viteve 2000 në miliona euro në vit, falë mbështetjes së donatorëve. Sigurisht, ne u qëndrojmë besnikë elementeve kryesore të mandatit, që janë: të drejtat e njeriut, shteti i së drejtës, reformat legjislativë dhe reformat në sektorë të tjerë, mbështetja e policisë kufitare, etj., etj. Gjithsesi, gjatë dy viteve të mia këtu, jam përpjekur që Prezenca të luajë një rol më të vogël në ndërmjetësimin politik, veçanërisht në fushën e reformës zgjedhore. Gjithsesi, me sa duket ekziston ende nevoja për ne, në kundërshtim me atë që do të shpresoja”.

Prezenca filloi punën në një kohë kur niveli i mirëbesimit mes grupeve të ndryshme politike në Shqipëri ishte shumë i ulët. Gjatë këtyre viteve, Prezenca është përpjekur shumë të rivendosë besimin dhe komunikimin mes partive të ndryshme politike. A mendoni se keni qenë të suksesshëm në këtë aspekt? E thënë në vija më të përgjithshme, a janë politikanët shqiptarë më të aftë për të arritur konsensus për çështjet themelore me interes kombëtar, se sa kanë qenë dhjetë apo pesëmbëdhjetë vjet më parë?

“Nuk mund të bëj krahasime të tilla të drejtpërdrejta personalisht ... dhe nuk do të ishte e përshtatshme. Vështirësia mbetet se si konsensusi për disa çështje me rëndësi strategjike për Shqipërinë, të përkthehet në një marrëdhënie më konstruktive mes shumicës dhe opozitës në trajtimin e çështjeve të funksionimit të qeverisjes. Vështirësia është se si të tejkalohet prirja për ta shndërruar thuajse çdo çështje legjislativë ose qeverisjeje në një *casus belli*, dhe në shkak për pengesë, bojkot dhe madje edhe protesta në rrugë. Kjo, sigurisht, kërkon që argumentet e arsyeshme të opozitës të dëgjohen e të merren parasysh – dhe jo të injorohen nga shumica. Kur ky proces shteron, është ndryshimi i programeve politike që zakonisht nxjerr fituesin dhe pastaj vendimet e shumicës duhet të respektohen nga pakica. Nuk është fundi i botës, por është fundi i një debati të caktuar për një vendim të caktuar. Thjesht sepse votuesit vendosën kështu në zgjedhjet e fundit dhe vendimi i tyre duhet të jetë i vlefshëm deri në zgjedhjet e ardhshme. Të gjitha këto që po them

mund t'ju tingëllojnë si “urtësi e nxjerrë nga faqet e një libri”, por arritja e një atmosfere të tillë është ndoshta çështja më strategjike me të cilën përballet Shqipëria”.

Duket se ka pritshmëri të ndryshme lidhur me rolin që OSBE-ja duhet të luajë në politikën shqiptare. Disa e shohin atë si arbitër, të tjerë thjesht si një ndihmës diskret në prapaskenë, ndërsa të tjerë duan ende që OSBE-ja të ketë një rol më aktiv përmes ofrimit të propozimeve konkrete, të cilat do të zhblokonin ngërçet. A mund ta sqaroni mandatin e OSBE-së gjatë “krizave të ndryshme politike” që shfaqen hera-herës në skenën politike shqiptare?

“Ne jemi të mandatuar për të dhënë ndihmesën tonë në reforma të ndryshme kyçe dhe kjo gjë historikisht ka përfshirë ndihmesën në proceset politike. Unë jam përpjekur ta zvogëloj përfshirjen e Prezencës në ndërmjetësime të tilla dhe sinjerisht shpresoja që marrëveshjet për reformën dhe zonat zgjedhore në vitin 2004/fillimin e vitit 2005 të ishin të fundit. Prandaj, nevoja për marrëveshjen e 30 gushtit ishte në vetvete një dështim për klasën politike. Gjithsesi, shpresoj që të ketë ende një mundësi që marrëveshja të japë rezultat”.

TT: Kohët e fundit, ka pasur shumë kritika ndaj OSBE-së për pozicionin e saj në reformën zgjedhore, kryesisht nga politikanë të opozitës. Cili ka qenë pozicioni i OSBE-së dhe si ju përgjigjeni kritikave të tilla?

“Ne nuk marrim pozicione publike në debatin politik vendas për reformën zgjedhore... dhe as në çështje të tjera. Ne thjesht ndjekimin paketën e rekomandimeve të përgjithshme të bëra nga misionet ndërkombëtare të vëzhgimit dhe ndonjëherë ofrojmë këshilla ligjore dhe teknike më specifike. Këto këshilla mbështeten shpesh jo vetëm në standarde të mirënjohura, por edhe në praktika të ndryshme dhe po, edhe në logjikën e thjeshtë. Ky është një vend sovran dhe rrjedhimisht partnerët tanë shqiptarë janë patjetër të lirë të mos i pranojnë këshillat tona. Unë nuk e kam problem këtë zgjedhje. Le të shpresojmë vetëm që në raste të tilla vendimet e politikanëve të jenë të informuara dhe të shqyrtuara në terma politike dhe teknike, duke qenë në dijeni të plotë të pasojave, si në vend, ashtu edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Unë e kam të vështirë të kuptoj atëherë kur sloganet zëvendësojnë faktet, pretekstet zëvendësojnë çështjet dhe ku korrierët sulmohen e mesazhi injorohet. Çështja është se çfarë ka arritur konkretisht klasa politike për të realizuar reformën zgjedhore? Çështjet, gjithashtu, ndryshojnë me kalimin e kohës. Për shembull, nëse ke bërë një debat shterues e të gjatë për numrin e anëtarëve në komisionet zgjedhore vetëm një vit para zgjedhjeve, atëherë, sigurisht, mund ta kishe rritur numrin e administratës zgjedhore nga 35.000 në 50 ose 60 mijë – sepse këtë efekt do të kishte ngritja e komisioneve me njëmbëdhjetë anëtarë. Është çështje tjetër nëse kjo gjë mund të arrihet në vetëm dy muaj që kanë mbetur nga data ligjore për zhvillimin e zgjedhjeve vendore – sidomos kur e dimë që KQZ-ja ka qenë e shqetësuar për një ngarkesë të tillë pranverën e kaluar. Kur ngrejmë çështje të tilla, synimi ynë është të ofrojmë ndihmesën tonë në një debat të arsyeshëm që duhet të zhvillohet mes aktorëve politikë vendas dhe aq më pak me bashkësinë ndërkombëtare. Më pyetët për fyerjet...? Ato s' meritojnë përgjigje”.

Sipas jush, a është Shqipëria në rrugën e duhur përse u përket reformës së Kodit Zgjedhor dhe infrastrukturës zgjedhore?

“S’ka pikë dyshimi që Shqipëria nuk është në rrugën e duhur drejt zgjedhjeve më të mira vendore. Reforma, të paktën reforma që ndikon në zgjedhjet vendore, e cila duhet të ishte kryer tashmë, nuk ka marrë miratimin e palëve dhe përgatitjet teknike janë vonuar për shkak të manovrave politike dhe legjislative. Dhe, sigurisht, moti që bën zakonisht gjatë kornizës ligjore të zgjedhjeve vendore nuk e tën më të lehtë zhvillimin pa probleme të rutinës zgjedhore, të paktën kështu është në disa pjesë të vendit. Gjithsesi, ky problem i fundit ka qenë i mirëditur nga të gjithë. A nuk dihej kjo më së miri gjatë reformës së fundit zgjedhore? A nuk paska pasur kohë të mjaftueshme për të debatuar dhe për të rënë dakord për të gjitha çështjet kyçe që nga shtatori 2005?”

Si e parashikoni të ardhmen e Prezencës së OSBE-së pas zgjedhjeve?

“Mund të shpresoj që zgjedhjet do të jenë dukshëm më të mira se sa ato në të shkuarën, por mundësitë që kjo të ndodhë zvogëlohen dita-ditës, për sa kohë që nuk përmbyllet debati për reformën zgjedhore dhe nuk bëhen përgatitjet teknike. Përndryshe, ne kemi planet tona standarde për vitin 2007, që përfshijnë buxhetin, i cili konsultohet me qeverinë dhe diskutohet në Vjenë, dhe ne do të ndjekim këto plane. Jeta vazhdon edhe pas zgjedhjeve...”

Doni të shtoni ndonjë gjë tjetër?

“Si ju duket kjo: “Nuk të duhet një meteorolog për të ditur nga fryn era...” (E ka thënë Bob Dylan... më duket në këngën e parë të albumit të tij të parë “elektrik”, në vitin 1965...)”